

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, TIRANË ME OBJEKT “MBI LIGJSHMËRINË
DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE” PËR PERIUDHËN 01.01.2014–
31.12.2014.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me objekt “Auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën 01.01.2014 deri në 31.12.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 141, datë 06.10.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 487/9, datë 06.10.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar znj. Milva Ekonomi, Drejtor i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi mbi vlerësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik, si dhe gjetjet e konstatuara nga kontrollat e kësaj Drejtorie, kanë rezultuar problematikat e mëposhtme:

Nga Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik në FOND, ishin parashikuar për kontroll vetëm 3 subjekte farmaceutike që rezultojnë me vlera të larta rimbursimi, të konsideruara si farmacitë në “*Top Listë*” në Drejtorinë Rajonale të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, ndërkohë që subjektet e tjera të kësaj liste “*N 2*”, “*N 1*”, “*G & Li*”, “*N*”, “*Cs*”, “*Ji*”, “*MF*”, “*S*”, “*R*” dhe “*S.P*”, të cilat kanë një rimbursim vjetor në vlera të larta, që variojnë nga 27 milionë lekë deri në 102 milionë lekë, nuk ishin parashikuar për kontroll, veprime që bien ndesh me Udhëzuesin Metodik nr. 2, datë 26.10.2010, ndryshuar me vendimin nr. 101, datë 22.10.2014 të Këshillit Administrativ të FONDI-t, ku ishte miratuar Rregullorja nr. 3, datë 22.10.2014 “Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuar me Fondin”, përcaktohet: “... T’u jepet prioritet për kontroll subjekteve farmaceutike me një vlerë rimbursimi mbi 1.5 milion lekë” dhe se “DKPF pranë FONDI-t kontrollon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, në zbatim të skemës të detyrueshëm të kujdesit Shëndetësor nga subjektet e kontraktuara nga FONDI për: Subjektet farmaceutike me vlerë mesatare rimbursimi në muaj të barabartë ose më lart se 2,000,000 lekë...Kontrollin e aktivitetit të subjekteve farmaceutike të kontaktuara bazuar në luhatjet e vlerave mujore”.

Nga auditimi konstatohet se, nuk janë kontrolluar disa nga farmacitë e “Top Listës”, pra me vlera të larta të rimbursimit, ku numri i pacientëve dhe i recetave është i ulët, konkretisht farmacitë “*N*” dhe “*C*”, të cilat kanë vlera rimbursimi respektive 47,558,450 lekë dhe 41,705,138 lekë, çka tregon për rimbursim të recetave me barna të alternativave të shtrenjta.

-Nuk ishte realizuar kontrolli në farmacitë e QSUT, mbi qarkullimin e barnave më të shtrenjta që tregtohen në to, të cilat arrijnë vlerën **1,835,591,414 lekë**, duke mos bërë të mundur monitorimin e aktivitetit të këtyre farmacive, pranë DSHSUKS mbi zbatimin kontratës, akteve ligjore dhe nënligjore, për të bërë të mundur ndalimin e fenomeneve abuzuese nga subjektet dhe në interes të skemës së sigurimeve, trajtuar më hollësisht në faqe 108-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë është rekomanduar:

Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të merren masa të menjëhershme që, në mbështetje të Rregullores “Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të

dhënësve të shërbimit të kontraktuar me Fondin”, të planifikohen e kontrollohen me prioritet farmacitë me rimbursim në vlera të larta dhe me luhatje të rimbursimit gjatë muajve.

Gjithashtu, të kontrollohen barnat me rimbursim më të lartë, që tregtohen në farmacitë e QSUT-së, në Qendrat e tjera Spitalore në Tiranë, si dhe në farmacitë e spitaleve Rajonale, të cilat plotësojnë nevojat e pacientëve të veçantë që trajtohen në këto shërbime spitalore.

Menjëherë

2. Nga auditimi konstatohet se, janë ushtruar *kontrolle të përsëritura në disa farmaci, të pa bazuar mbi fakte a indicie problematikash, ose që të kishin luhatje të vlerave mujore të rimbursimit*, si në rajonet Tiranë, Durrës, Korçë dhe Dibrë, nga ku vetëm në Rajonin e Tiranës ***në muajin Dhjetor 2014*** ishin kryer *përsëritje të kontrolleve për 16 subjekte farmaceutike, të pandryshuara.*

Programet e kontrollit në këto farmaci, *nuk ishin hartuar dhe sigluar nga përgjegjësi i sektorit farmaceutik, por nga përgjegjësi i grupit i caktuar për kontroll, duke anashkaluar dhe kapërcyer kompetencat, veprim ky në kundërshtim me Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe përkrahjet e punës për Drejtorinë e Përgjithshme të FONDI-t.*

-Në planifikimin e kontrollit të depove nuk kishte kriteret të vendosura për përzgjedhjen e tyre për kontroll, por i lireshin një indicie apo një informacioni verbal, ose planit të auditimit të ardhshëm.

Konstatohet anulimi i kontrollit, pa asnjë arsye në Depon O, ku nga auditimi i kësaj praktike u konstatuan shkelje e mangësi, si dhe rimbursim fiktiv nga subjektet farmaceutike në ***shumën 30,710,920 lekë, vetëm për barin “Ketosteril”,*** të tregtuar nga kjo Depo.

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore *“Mbi plotësimin e kriterëve për kontratën e lidhur me FONDIN dhe detyrimet që rrjedhin prej saj”* për Depon Importuese “O”, me adresa në Kashar dhe Tiranë, por dhe për distributorët e tjerë, rezultoi se: *Nga Komisioni i ngritur me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm, nuk ishte bërë përzgjedhje korrekte, pasi nga 9 (nëntë) Depo nuk plotësoheshin kriteret e pacaktuara sipas vendimit të KA nr. 48, datë 10.12.2013 dhe Udhëzimit nr.14, datë 19.12.2013, pasi mungonin Formularët tip të deklarimit, Inventari i gjendjes fizike të barnave të skaduara dhe Autorizimet e kompanive farmaceutike prodhues vendas ose të huaj. Në rastin e miratimit të kontratës me Depon O, komisioni ishte i përbërë nga dy persona.*

-Nga auditimi në institucion rezultoi se, FONDI dhe njësitë e varësisë, rimbursojnë subjekte të ndryshme farmaceutike, pa u verifikuar dhe saktësuar më parë mbi deklaratimet e tyre, jo vetëm në sistemin elektronik e-farmacitë, por dhe atë të dokumentacionit shkresor që dorëzojnë ato referuar kushteve kontraktuale, duke krijuar mundësinë që të përfitohet nga ato rimbursim në mënyrë të padrejtë, *trajtuar më hollësisht në faqe 108-131 dhe 151-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar:

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të merren masa të menjëhershme që, në mbështetje të Rregullores nr. 3, datë 22.10.2014 *“Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuar me Fondin”,* të rishikohen planet dhe programet e kontrollit, si dhe t’i kushtohet vëmendje monitorimit të skemës nëpërmjet programeve të posaçme, për të siguruar në të ardhmen zbulimin dhe dënimin e fenomeneve abuzuese me skemën e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor, duke u përqëndruar te veprimtaria e mjekut të familjes, mjekut specialist, farmacistëve dhe të siguruarit nga skema.

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të merren masa, që në mbështetje të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e institucionit, të rishikohen dhe riorganizohen strukturat e kontrollit, në një strukturë të vetme,

me qëllimin e ngritjes së një strukture sa më eficiente dhe produktive, pasi në këtë institucion përveç drejtorisë së cilësuar më lart funksionojnë edhe dy drejtori të tjera kontrolli, si: Drejtoria e Kontrollit Spitalor dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm.

Menjëherë

3. Nga auditimi i zbatimit të buxhetit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor u konstatua se:

-Nga të dhënat e raportuara nga Ministria e Financës, referuar zbatimit faktik të buxhetit, krahasuar me ato të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, rezulton një diferencë në të ardhurat për **166.5 milionë lekë**, të cilat i përkasin transfertës së buxhetit për shërbimin spitalor dhe që raportohen më shumë nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Ndërsa, në shpenzime rezulton një diferencë për **3.5 milionë lekë**, përkatësisht në shpenzimet e shërbimit spitalor, të cilat raportohen më pak nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

-Për vitin 2014, janë likuiduar shpenzime rimbursimi sipas listëtreguesve, gjithsej në vlerën 8,251,406 mijë lekë, nga 8,340,000 mijë lekë të programuara, ose shpenzimet e rimbursimit janë realizuar 98.9% e programimit. *Realizimi në këto nivele të shpenzimeve të rimbursimit të barnave nuk është rezultat i menaxhimit efektiv të fondeve të planifikuara për këtë zë të shpenzimeve, por këtu ka ndikuar heqja e TVSH-së për barnat nga muaji prill 2014, si dhe zbatimi i Urdhërit të Ministrit Shëndetësisë nr. 320, datë 29.07.2014 për tregtimin e disa barnave të listës të rimbursueshme nëpërmjet farmacive spitalore, që ndikon në përjashtimin e marzhit të fitimit të farmacive të rrjetit të hapur. Nëse do të ishte bërë korektimi i planit për heqjen e TVSH për barnat, treguesit e zbatimit të buxhetit do të ishin më të saktë, pra në këtë mënyrë do të kishim një linjë korrekte të raportimit, trajtuar më hollësisht në faqe 21-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar:

-Të merren masa nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të bëhet rakordimi dhe raportimi i saktë për evidentimin dhe rakordimin e saktë si të të ardhurave dhe shpenzimeve, e veçanërisht ato që përballohen nga buxheti i shtetit, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten fenomene të tilla.

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në të ardhmen për çdo ndryshim të funksionimit e aplikimit të Listës së Barnave, të bëhen korigjimet e duhura në treguesit e buxhetit, kjo jo vetëm për ti shërbyer transparencës në vlerat e rimbursuara, por dhe evidentimit të anomalive në rimbursime, ashtu sikurse ka ndodhur dhe parandalimin në kohë të tyre.

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për realizimin e objektivave në zbatimin e skemës së kujdesin shëndetësor, të bashkëpunohet me Ministrinë e Shëndetësisë, por duke qenë institucion autonom, të administrojë vetëm çështjet financiare të vetë FONDI-t.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Administrativ, në mbledhjen e të datës 17.12.2014, u konstatua se:

-pika nr. 12 e rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e “Projektvendimit për miratimin e kontratave tip S/2015”, nuk rezulton të jetë e miratuar, pasi cilësohet vetëm fillimi i diskutimit për këtë pikë, por nuk ka cilësim nëse është miratuar apo jo me shumicën e anëtarëve;

-nuk del e qartë, nëse është marrë në diskutim nga Këshillit Administrativ, pika 13 e rendit të ditës, me objektin *“Për miratimin e kontratave tip për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore me institucionet shëndetësore private”*, të shoqëruara me 4 tip kontratash për financimin e paketave shëndetësore të 4 shërbimeve me institucionin privat.

Për këtë pikë në procesverbal ka vetëm një cilësim se miratohet me votat e të gjithë të pranishmëve, duke kaluar më pas tek pika tjetër nr. 14 e rendit të ditës. Pra, nuk është lënë gjurmë nëse është shtruar për diskutim pika 13 e rendit të ditës, *trajtuar hollësisht në faqen 16-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar:

Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH-së ti ridërgojë edhe një herë në mbledhjen e KA për të kryer veprimet përkatëse (*diskutimet dhe miratimet të cilësuar më lartë*) për ish pikën nr. 12 të rendit të ditës, që ka të bëjë me: *“Projektvendim për miratimin e kontratave tip S/2015”*, si dhe ish pikën 13 të rendit të ditës, me objektin: *“Për miratimin e kontratave tip për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore me institucionet shëndetësore private”*.

Menjëherë

5. Në mbledhjet e realizuara të KA, të reflektuara në procesverbalet përkatëse, u konstatuan raste që duhej të kishte më shumë qartësi, korrektësi dhe rregullaritet në këto procesverbale, si: nuk kanë nënshkruar të gjithë anëtarët pjesëmarrës të KA; trajtimi i materialeve e konkluzioneve të mbledhjeve sipas pikave të programit të përcaktuar në rendin e ditës nga Drejtori i Përgjithshëm nuk plotësohej me cilësimet e diskutimeve dhe miratimeve përfundimtare; etj., *të trajtuar hollësisht në faqen 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar:

-Procesverbalet e mbledhjeve, të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës të KA, si dhe në fund të këtyre procesverbaleve të vendoset emër mbiemri përkatës i përpiluesit, duke u shoqëruar edhe me nënshkrimin e tij, e kjo në zbatim të rregullores së brendshme të FSDKSH.

-Gjithashtu, në hyrje të procesverbaleve të mbledhjeve të shënohen edhe emrat dhe detyrat përkatëse të punonjësve të tjerë që janë të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjet e KA.

Për çdo mbledhje të bërë.

6. Nga auditimi i kryer mbi likuidimet për trajtime mjekësore të pacientëve jashtë vendit, të miratuara me vendime të veçanta të KM konstatohet se, shpenzimet e rimbursimit të këtyre pacientëve nuk ishin kryer konform kërkesave të VKM nr. 638, datë 01.10.2014 *“...pagesat e trajtimeve jashtë vendit, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, rast pas rasti”*, pasi përveç rasteve të rimbursimit të shpenzimeve për trajtime të kryera jashtë vendit, ishin kryer dhe shpenzime për mbulimin e mjekimit në spitalet private brenda vendit, ***gjithsej në shumën 9,092,722 lekë.***

U konstatua se, *në 3 raste në vlerën 6,004,668 lekë, rimbursimi ishte kryer për periudha jashtë afateve të miratuara me VKM*, si më poshtë:

-Likuiduar shuma 1,400,000 lekë, për trajtim shëndetësor, të miratuar me VKM nr. 787, datë 17.12.2014, ku bashkëlidhur është kërkesa nga i interesuari drejtuar FSDKSH dhe fatura origjinale nga spitali (AOUS), e cila mban datën 18.07.2012.

-Likuiduar shuma 1,854,668 lekë, për trajtim shëndetësor, miratuar me VKM nr. 899, datë 17.12.2014, ku bashkëlidhur është fatura origjinale nga spitali, e cila mban datën 18.07.2012.

-Likuiduar shuma 2,750,000 lekë, për trajtim shëndetësor, miratuar me VKM nr. 792, datë 19.11.2014, ku bashkëlidhur janë faturat origjinale nga spitali turk “A h”, por që i përkasin datave 18.05.2006 dhe 02.09.2008.

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se, faturat për shpenzimet e mjekimit në Spitalet a klinikat jashtë vendit dhe pse janë të noterizuara, ato nuk janë konform pikës 4 të Vendimit të KM nr. 134, datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë”, në të cilën citohet se “Dokumentet e autoriteteve të huaja, që do përdoren brenda vendit, legalizohen në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara në Tiranë, legalizohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme”, trajtuar më hollësisht në faqe 43-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë është rekomanduar:

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, për të mos lënë vend për përfitime të padrejta, si dhe për të adresuar qartë përgjegjësitë në rastet e shmangieve nga kërkesat ligjore, rimbursimi i shpenzimeve për trajtime spitalore të bëhet bazuar në kriteret e mirëpërcaktuara, kërkesë e preventiv paraprak dhe dokumentacion të plotë shoqërues, të miratuar rast pas rasti konformë dispozitave ligjore.

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Sektori i Financës, në rastet e pagesave që justifikohen me dokumente administrativë të vendeve të huaja, të kërkohej plotësimi i tyre konform VKM nr. 134, datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë dhe vazhdimisht

7. Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm rezultoi se, nga 26 rekomandime të lëna gjithsej, 18 rekomandime janë zbatuar dhe 8 rekomandime janë zbatuar pjesërisht e janë në proces realizimi *trajtuar më hollësisht në faqe 8-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar, të vazhdojë ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të mëparshme:

-Institucioni të vazhdojë punën, për evidentimin e saktë të ngarkesës së mjekut të familjes, pastrimin në vazhdimësi të regjistrit elektronik të banorëve nga dublikimet, si dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për përcaktimin e saktë të banorëve.

-Institucioni të ndjekë problematikën e konstatuar për medikamentet e skaduara në Spitalin e Durrësit dhe asgjësimin e tyre sipas dispozitave ligjore në fuqi, detyrë që vazhdon të jetë prej shumë kohësh në proces.

-Institucioni të vazhdojë negociimet jo vetëm me Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH), por edhe me Ministrinë e Financave, ku të kërkohej ***transferimi i diferencës së mbetur në shumën 215,495 mijë lekë, në llogarinë bankare të ISKSH,*** si detyrime të prapambetura nga kontributet e mbledhura për sigurimet shëndetësore dhe të pa transferuara në llogaritë e FONDI-t.

-Institucioni të vazhdojë të ndjekë në rrugë administrative dhe ligjore dokumentimin ose lirin e sipërfaqes prej 15 m² të zënë nga ish shoqëria “ÇEZ Shpërndarja” sh.a, aktualisht “OSHE”, pasi pavarësisht komunikimeve midis palëve kjo çështje nuk ka gjetur zgjidhje.

-Institucioni, meqenëse ka përfunduar çështja gjyqësore për rikonstruksionin e godinës, të përshpejtojë punën për sigurimin e ambienteve të përshtatshme për magazinimin e mallrave, në mënyrë që të garantohej ruajtja dhe administrimi i vlerave materiale.

-Nga institucioni të ndiqet në vazhdimësi deri në arkëtimin e plotë të dëmit ekonomik nga 19 persona, në vlerën 154,000 lekë dhe nga 8 punonjësit e tjerë të institucionit të vlerës 99,059 lekë.

Në vazhdimësi

8. Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nëpërmjet veprimeve me bankën u konstatua se:

- Dokumentacioni justifikues për shpenzimet për udhëtim e dieta nuk ishte i plotë, në të gjitha rastet ftesat për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme nga institucione homologe, nuk kishin të përcaktuar qartë mbulimin financiar të shpenzimeve. Ftesat për këto shërbime nuk ishin bashkëlidhur pagesave, pasi ato mbaheshin nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”* dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

Në kryerjen e shpenzimeve për biletat e udhëtimit me jashtë, është anashkaluar procedura e prokurimit publik nëpërmjet platformës elektronike të APP, për vlerën 3,860,476 lekë, pasi nga institucioni janë realizuar me procedurë të thjeshtë, duke marrë 3 oferta nga operatorët e duke përzgjedhur vetë agjencinë e fluturimit *trajtuar më hollësisht në faqe 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

- Nga auditimi i veprimeve të kryera, për zbatimin e kontratës për shërbimin e ruajtjes së objektit u konstatua se, ato kryheshin vetëm duke u mjaftuar me listë prezencën e hartuar nga sipërmarrësi i shërbimit, e konfirmuar me procesverbalin e hartuar nga Autoriteti Kontraktor, të nënshkruar nga personi i caktuar për monitorim, vetëm duke cituar se *“jam dakord me listë prezencën e paraqitur”*, por pa e verifikuar nëse kryhej faktikisht ose jo shërbimi sipas kushteve të vendosura në kontratë për 5 rojet sipas turneve përkatës të secilit, mënyrë kjo, që nuk tregon kryerjen korrekte të shërbimit dhe konform kushteve të kontratës *trajtuar më hollësisht në faqe 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

- Nga auditimi i dokumentacionit bankar u vërejt se, për periudhën 01.01.2014 deri më datë 02.09.2014, urdhër shpenzimet dhe dokumentacioni bankar janë nënshkruar si firmë e dytë nga ish Përgjegjësi i Sektorit të Financës, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, neni 12, pika 1, *“Nëpunësi zbatues i njësisë publike është punonjës i nivelit të lartë të menaxhimit të njësisë publike...”*. Sipas shkresës nr. 3464, datë 02.09.2014 është bërë njoftimi për zëvendësimin e firmës së dytë të nëpunësit zbatues, për llogarinë bankare. Edhe pse është bërë ky ndryshim, punonjësi ka të njëjtin nivel menaxherial, pra veprimi është sërish në kundërshtim me ligjin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, *trajtuar më hollësisht në faqe 38-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

Për këtë është rekomanduar:

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Sektori i Financës, për çdo rast shpenzimi për udhëtim e dieta, dokumentacioni të plotësohet konform kërkesave të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”* dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*. Për çdo rast ftesat për shërbime me jashtë duhet të kenë të mirëpërcaktuar mbulimin financiar, sipas dispozitave nënligjore, ndërsa shërbimi për blerjen e biletave të avionit në udhëtimet me jashtë vendit të kryhet nëpërmjet platformës së APP, në përputhje me kërkesat e LPP.

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Menaxhimit të Aktiveve, të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme kryerja e shërbimit të ruajtjes së objektit, duke e pasqyruar me dokumentacion të saktë, me qëllim mirëmenaxhimin sa më efektiv të fondeve.

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, përcaktimi i nëpunësit autorizues dhe atij zbatues, të bëhet sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, për delegimin e detyrave dhe përgjegjësi ve menaxheriale, ku nëpunësi autorizues dhe zbatues të përcaktohen sipas nivelit menaxherial të caktuar dhe sipas profesionit përkatës.

9. Nga auditimi i procedurave të prokurimit të fondeve publike, fokusuar në realizimin e qëllimit të ligjit, si dhe në parimet themelore të prokurimit publik, si: rritja e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik; sigurimi i mirë përdorimit të fondeve publike dhe të uljes së shpenzimeve procedurale; nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe nxitjes së konkurrencës ndërmjet tyre; sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë konkurrentët pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik, si dhe trajtimin të barabartë të ofertuesve, dhe barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve, për përdorimin efektiv të fondeve publike, u konstatuan mangësi të njëjta dhe të veçanta për procedurat e prokurimit publik të audituara, të lidhura me mungesën e harmonizimit të punës midis Njesisë së Prokurimit Publik dhe KVO-ve, si dhe qëndrime të ndryshme teknike të këtyre strukturave, interpretime dhe keqinterpretime, të cilat ndikojnë edhe në nxitjen e ulët të konkurrencës, në këto tenderime, trajtuar më hollësisht në faqe 66-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. *Bazuar në këtë fakt, në drejtim të përmirësimit të punës, që do të shoqërohej me një efikasitet të plotë të fondeve, në arritjen e objektivave të këtij institucioni, është rekomanduar:*

i) Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FDKSH), për të ardhmen, të merren të gjitha masat, që procedurat e prokurimit publik, të fillojnë që në ditët e para të muajit Janar e të vazhdojnë deri në momentin e shpalljes së fituesit, duke pritur për aq kohë, sa do të çelen fondet përkatëse, e jo siç është vepruar deri tani, që kanë filluar nga muaji Mars.

Vazhdimisht

ii) Nga FSDKSH të merren masa, për të bërë ndryshimin e përbërjes së anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, si dhe të bëjë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të tyre, nëpërmjet APP-së. Gjithashtu të merren masa që, kur të caktohen anëtarët e KVO-së, detyrimisht njëri prej tyre të jetë specialist i fushës, sipas tenderëve objekt prokurimi si dhe në dokumentet e tenderit të vendosen profesionet përkatëse të tyre, kjo në respektim të kërkesës së VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”.

Në vijimësi

iii) Nga komisionet e llogaritjes së fondeve limite dhe caktimit të specifikimeve teknike të blerjeve e shërbimeve, të merren masa:

-që të përcaktohen shumë qartë specifikimet teknike, për t’u kuptuar lehtësisht nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender, kjo në zbatim të nenit 23 “Specifikimet teknike”, pika 1 e LPP;

-llogaritjet e fondeve limite për tenderët që, fondet përcaktohen me variantin e studimit të tregut, përveç ofertave ekonomike që merren me shkrim nga kompani furnitorësh apo shërbimesh, paralelisht të bëhet e mundur edhe marrjet e çmimeve nëpërmjet rrjetit të internetit të po këtyre furnitorëve, pasi vlerat e dhëna para konkurrimit ishin rreth 30% më të larta se sa vlerat në ofertat ekonomike në momentet që paraqiten në konkurrim.

Për çdo tender

iv) Nga Njësia e Prokurimit, për të ardhmen, të merren të gjitha masat, që kërkesat kualifikuese të veçanta, të hartohen në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit, që kërkohet të prokurohet, të vendosen kriteret të nevojshme, pa lënë shteg për interpretime, si dhe të jenë shumë të kuptueshme deri tek bizneset e vogla e të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik. Për kërkesat kualifikuese të miratuara, detyrimisht të kërkohen shoqërimet me dokumentet vërtetues, si dhe të përcaktohen organet përkatëse, që lëshojnë dokumente të

tilla vërtetuese. Gjithashtu, kërkesat kualifikuese të veçanta të miratuara për konkurruesit, detyrimisht të argumentohen, duke shpjeguar arsyet përkatëse.

Për çdo tender

v) Nga KVO-të, të merren masa, që fituesit e shpallur nga realizimi i tenderëve, detyrimisht duhet të jenë me plotësim 100% të kërkesave kualifikuese të miratuara nga Njësia e Prokurimit, e kjo në zbatim të rregullave të prokurimit publik, ku cilësohet se mos plotësimi i kërkesave kualifikuese është kusht s'kualifikimi. Gjithashtu, kur ka konkurrentë, që paraqiten me vlera të ulta, vetëm për rastet që, ka devijime të vogla, natyrisht, kur të gjithë konkurrentët paraqiten me ndonjë mos plotësim të kërkesës kualifikuese dhe mund të riparohen në vazhdim të procedurës së prokurimit, Autoriteti Kontraktor duhet të përdorë edhe pikën nr. 4 të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, e LPP, që cilëson: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”.

Për çdo rast

vi) Nga KVO-të, të merren masa, që anëtarët të futen në faqen e platformës elektronike të APP-së në mënyrë të pavarur, duke shkruar secili argumentimin e vet për mungesa dokumentacionesh, apo mos plotësim të kërkesave kualifikuese për operatorët ekonomik konkurrues. Në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë argumentime të përbashkëta.

Gjithashtu nuk duhen cilësuar argumentimet e skualifikimeve në platformën elektronike të APP-së në 3 rubrikat e llojeve të dokumenteve (*faktike, teknike dhe financiare*), në një kohë kur nuk ka mos plotësim vetëm të ndonjë rubrike dokumentare.

Për çdo rast

10. Nga auditimi i ushtruar mbi vlerësimin e veprimtarisë së Auditit të Brendshëm rezultoi se, janë evidentuar gjetjet:

-Nuk ishin planifikuar dhe nuk ishin realizuar kontrole në rajone me peshë të lartë specifike të shpenzimeve të rimbursimit dhe nuk janë kontrolluar mjekë që janë në “Top Listën”, ose mjekë me luhajtje të mëdha rimbursimi të pajustificuara nga muaji në muaj.

-Ishin ushtruar kontrole edhe në subjektet farmaceutike të cilat nuk ishin parashikuar në programin e kontrollit, si në Rajonin Korçë, Berat, Fier.

-Katër subjekte farmaceutike dhe konkretisht: “I”, “A”, “R”, “F” ishin kontrolluar me të njëjtin program kontrolli.

-Nga auditimi rezultoi se, *për shkak të numrit të kufizuar të specialistëve të Sektorit të Performancës*, auditimet e performancës, të kryera në Drejtoritë Rajonale Fier, Berat, Elbasan, Korçë, Dibër etj., janë realizuar edhe nga struktura të tjera të kësaj drejtorie, *trajtuar më hollësisht në faqe 131-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

Për këtë është rekomanduar:

-Gjetjet e Raporteve Përfundimtare të dala nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të shqyrtohen me seriozitetin e duhur nga të gjithë menaxherët që janë përgjegjës për mbarëvajtjen e proceseve të punës në institucion dhe të përdoren për të evidentuar pikat e dobëta të institucionit, duke bërë të mundur parandalimin e fenomeneve në të ardhmen.

-Drejtorja e Auditit të Brendshëm, në bazë të auditimeve që kryen tek njësitë vartëse, ti fokusojë planet e auditimeve në bazë të subjekteve me më shumë risk, duke ndërtuar një regjistër të subjekteve që kanë më shumë shkelje për orientimin e planit të auditimeve, në mënyrë që të evidentohen në kohë problematikat.

-Gjithashtu, të forcohet kontrolli i brendshëm nga strukturat bazë, sikurse janë drejtoritë rajonale, të rritet efektiviteti i kontroleve të kryera nga drejtoritë qendrore të kontrollit, të përmirësohet raporti i auditimeve në favor të atyre me bazë të lartë risku, si dhe të bëhet

identifikimi në kohë i riskut dhe të realizohet vlerësimi dhe mbulimi me kontroll i risqeve në marrëdhëniet me ofruesit privat të shërbimeve shëndetësore.

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të rikonceptohet dhe riorganizohet struktura e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm (*por jo vetëm*), në nivel sektorësh për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e sektorëve dhe burimeve njerëzore që kjo drejtori ka, duke bërë kështu rritjen e performancës së auditimeve dhe stafit të drejtorisë në lidhjen me përcaktimin e nivelit të riskut dhe të subjekteve me më shumë risk.

Menjëherë

11. Gjatë auditimit mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ka të përcaktuar ligjërisht misionin për qëllimin dhe zbatimin e skemës të sigurimeve të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, që gjen shprehje në ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011 “*Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar. U konstatua se, FSDKSH ka hartuar një Draft strategji që prej dhjetorit të vitit 2013, por që është e pa miratuar akoma nga KA. .

U konstatua se, *Manuali i Menaxhimit të Riskut* është i ndërtuar në mënyrë të saktë, por përcaktimi i risqeve nuk është bërë sipas fushave prioritare me më shumë risk.

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2014 Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), kishte funksionuar formalisht dhe për periudhën Janar-Tetor 2014 ishte mbledhur vetëm dy herë, ndërkohë që në manualin “*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*”, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010, pika 4.2.9 përcaktohet se “*Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit*”.

Ky mos funksionim, ka sjellë mos parashikimin e risqeve që janë bërë evidente në auditim si në sektorin e kontrollit farmaceutik, ku janë vërejtur se nuk janë zbatuar Udhëzimet për kontrollin në farmacitë me vlera të larta rimbursimi, si dhe mos respektim të programeve kontrolluese *trajtuar më hollësisht në faqe 144-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

Për këtë është rekomanduar:

-Nga institucioni të merren masa, që të miratohet draft Strategjia e Zhvillimit të FONDI-t, ku të detajohen në mënyrë të qartë përparësitë dhe strategjitë e këtij institucioni për të ardhmen, në bazë të kërkesave të ligjit të ri mbi sigurimet e detyrueshme të kujdesit shëndetësor dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

-Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të rikonceptohet *Manuali i Menaxhimit të Riskut*, ai të bëhet sipas fushave prioritare me më shumë risk, dhe përcaktimi i risqeve të bëhet sipas shkallës së rëndësisë.

-Në të ardhmen, GMS të respektojë dispozitat ligjore dhe manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave, duke funksionuar normalisht dhe mbledhja të kryhet sipas dispozitave të përcaktuara, në mënyrë që të ketë një mbarëvajtje të kontrolluar të institucionit dhe për të përmbushur misionin e krijimit të këtij Grupi.

-Në të gjitha hallkat dhe strukturat menaxhuese të rritet kërkesa për përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollit. Të punohet më shumë për kualifikimin e punonjësve, me qëllim aftësimin e tyre për identifikimin në kohë të risqeve e menaxhimin e tyre përmes kontrolleve cilësore. Të punohet në vazhdimësi për informatizimin e menaxhimit financiar, kontabilitetit, si dhe shërbimeve që kryejnë subjektet e kontraktuara. Në përputhje me realizimin e objektivave të FONDI-t, në vazhdimësi të realizohen dhe ndryshime strukturore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik, ***gjithsej në shumën 31,732,986 lekë***, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Nga auditimi i kryer në sistemin e Drejtorisë së Informacionit dhe Analizës Statistike në FOND, për barin “**Calcium -3- menthyl-oxovalerate etj.**”, me emrin tregtar “**Ketosteril -3- menthyl-oxovalerate, etj.**”, ose “**Ketosteril**”, u konstatua se:

Nga Depo Farmaceutike “O” (Kashar dhe Tiranë) janë deklaruar në FOND, shitje subjekteve farmaceutike të barit “Ketosteril”, për periudhën janar 2014-maj 2015, në sasinë ***prej 250,093 tableta që arrin në vlerën 30,710,920 lekë***.

Nga verifikimi i deklarimeve, për furniturat e kryera nga Depo për barin “Ketosteril”, konstatohet se, nga kjo Depo nuk është deklaruar sasi e barit “Ketosteril” të bërë hyrje nga Depo Importuese, apo subjekte farmaceutike, ***pra sasi të në hyrje të këtij bari në depo janë 0***. Kjo Depo ka deklaruar në FOND hyrje të barit nga subjekte “**Klient Kesh**”, pra të pa identifikuar si subjekte farmaceutike, nga të cilët janë kryer kthime të barit, veprime fiktive dhe abuzive nga Depo, të cilat kanë çuar në përfitim të padrejtë të shumës prej 30,710,920 lekë nga subjektet farmaceutikë, sipas listës nr. 3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga institucioni të merren masa për arkëtimin e dëmit ekonomik, nga subjektet farmaceutike, në shumën ***30,710,920 lekë***, sa përfituar në mënyrë abuzive nga rimbursimi i barit “Ketosteril”.

2. Në tenderin me objekt “**Blerje shtypshkrime të Kujdesit Parësor për vitin 2014**”, anëtarët e KVO-së, me përbërje A. V.-kryetar (Drejtoria e Përgjithshme-Këshilltar); M. K.-Përgjegjëse e Sektorit të Trajnimeve dhe I. Ç., Jurist në Drejtorinë e Legjislacionit të Zhvillimit të FONDI-t, përsa shpallur fituesin e tenderit pa plotësuar 100% kërkesat kualifikuese. Anëtarët e KVO-së duhej të kishin zbatuar nenin 53, pika 4, për devijime të vogla, meqenëse tenderin nuk e ka anuluar si dhe ka skualifikuar konkurrent me vlera me të vogla, duke sjellë dëmin ekonomik në vlerën prej ***130,056 lekë***.

3. Gjatë auditimit të shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit u konstatua se, janë likuiduar shpenzime për biletat e transportit brenda vendit, ***të cilat ishin thjesht fotokopje***, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, Udhëzimin e MF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe Vendimin e KA nr. 3, datë 07.02.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve të ISKSH-së dhe njësive vartëse të saj, që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, ***për 41 persona, gjithsej në shumën 427,320 lekë, e cila përbën dëm ekonomik*** dhe duhet të arkëtohet nga përfituesit, sipas listës nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. Nga verifikimi i kryer për rimbursimin e dy barnave të alternativave të shtrenjta bari “Cyproteron Acetate” 50 mg dhe bari “Acid Ibandronik” 50 mg, të ekzekutuara nga farmaci “Nek”, rezultoi se:

Në deklarimet e bëra në sistem për periudhën 1 Prill 2014-31 Mars 2015, kjo farmaci ka deklaruar gjendje në inventar të barit “Cyproteron Acetate” 50 mg, një sasi prej 40 tableta

dhe furnizuar me 1150 tableta, ka ekzekutuar receta për 1700 tableta dhe nuk deklaroi gjendje në fund të periudhës.

Pra, nga kjo farmaci janë ekzekutuar receta fiktive me rimbursim të barit "Cyproteron Acetate" 50 mg, për 510 tableta me çmim 161.4 lekë/ tabletë, duke përfutur rimbursim më tepër në vlerën 82,314 lekë.

Ndërsa për barin "Acid Ibandronik" 50 mg, nuk ka deklaruar gjendje në inventar të barit, është furnizuar me 420 f.c, ka ekzekutuara receta për 480 f.c dhe deklaroi gjendje në farmaci 168 f.c.

Pra, nga kjo farmaci janë ekzekutuar receta fiktive me rimbursim të barit "Acid Ibandronik" 50 mg, për 228 tableta me çmim 806.4 lekë/ tabletë, duke përfutur rimbursim më tepër në vlerën 183,859 lekë.

Për të dy barnat, nga kjo farmaci është përfutur në mënyrë të padrejtë vlera prej dhe 266,173 lekë, e cila duhet të arkëtohet nga ky subjekt farmaceutik.

5. Nga verifikimi i kryer për rimbursimin e barnave të alternativave të shtrenjta bari "Cyproteron Acetate" 50 mg dhe bari "Acid Ibandronik" 50 mg, të ekzekutuara nga farmaci "J", rezultoi se:

Subjekti farmaceutik "J", ka deklaruar në sistem për periudhën 1 Prill 2014-31 Mars 2015, se për barin "Cyproteron Acetate" 50 mg, nuk ka patur gjendje, kishte bërë hyrje 3,300 tableta dhe dalje 3,720 tableta dhe gjendje në fund 70 tableta, pra ka ekzekutuar receta fiktive për 490 tableta, ose 79,086 lekë, të cilat janë përfutur padrejtësisht nga subjekti.

Ndërsa për barin "Acid Ibandronik" 50 mg, ka deklaruar gjendje 22 f., kishte bërë hyrje 448 f. dhe dalje 300 f. dhe gjendje të pajustificuar është për +148 f., të cilat arrijnë një vlerë rimbursimi të pajustificuar për 119,347 lekë.

Për të dy barnat nga kjo farmaci është përfutur në mënyrë të padrejtë vlera prej 198,427 lekë, vlerë e cila duhet të arkëtohet nga subjekti.

C. MBI ZBATIMIN ME EFICENCË, EFIKASITET DHE EKONOMICITET I FONDEVE PUBLIKE

Në përfundim të auditimit mbi zbatimin e ligjshmërisë për likuidimin e shpenzimeve të kryera për blerjen e mallrave e kryerjen e shërbimeve rezultoi se:

- Nga auditimi u konstatua se, në buxhetet e Qendrave Shëndetësore, në artikullin 602 "mallra", janë bërë shtesa ***gjithsej në shumën 36,551 mijë lekë***, në zbatim të shkresave të Ministrit të Shëndetësisë "Mbi trajnimin e profesionistëve të shëndetësisë në Kujdesin Shëndetësor Parësor", ku është ngarkuar FSDKSH për planifikimin dhe alokimin e fondeve. Për këtë veprim edhe pse është miratuar nga Ministri, nuk ka vendimmarrje të Këshillit të Administrimit.

Referuar korrespondencave me ministrinë rezultoi se: ky proces është faza e II e "Projektit për zhvillim profesional", proces i cili është realizuar më parë nga Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Agjencinë Zbatuese të Projektit PDS2, në kuadër të Marrëveshjes së Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, ku janë përfshirë trajnime të stafit mjek dhe infermier, por dhe trajnime të personelit në lidhje me përdorimin e kompjuterit, etj. Gjithashtu, ky trajnim i stafit mjekësor është në vazhden e projektit, që synon depistimin e popullatës për faktorët e rrezikut dhe sëmundjet prevalente, projekt i cili po zbatohet gjatë vitit 2015 me koncesion.

Përdorimi i këtyre fondeve, pa vendimmarrje të KA, ndërkohë që ky shërbim i është dhënë subjektit privat me koncesion, ka rënduar padrejtësisht shpenzimet dhe rezultatin e FONDI-t trajtuar më hollësisht në faqe 21-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Nga auditimi i shpenzimeve “Për riparim fotokopje”, në vlerën **110,000** lekë, konstatohet se, argumentimi i fondit limit është kryer duke u nisur nga shkresa e Drejtorisë së Informacionit dhe Analizës Statistike, sipas ankesave dhe kërkesave që vijnë pranë drejtorisë dhe në kuadër të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve ka lind nevoja për kryerjen e riparimit dhe mirëmbajtjes së fotokopjeve të FSDKSH. Nga verifikimi i dokumentacionit të likuidimit rezultoi se, për këtë procedurë mungonin: kërkesat dhe ankesat për mosfunksionim të fotokopjeve, sipas të cilave duhej të argumentohej nevoja e këtij shërbimi, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlera të vogla dhe të larta”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 57, datë 12.06.2014 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe”, si dhe nuk është mbajtur akt kolaudimi për riparimin e fotokopjave e nuk ka garanci për shërbimin, edhe pse nga komisioni është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit trajtuar më hollësisht në faqe 41-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Nga auditimi i likuidimeve për blerjen e 9 regjistrave (bypass aorokoronar, intervepte valvulare dhe congeniale) në vlerë prej **405,000** lekë konstatohet se, përlllogaritja e fondit limit është realizuar nga komisioni i ngritur për testimin e tregut, ku sipas procesverbalit të mbajtur, referuar tre ofertave nga operatorët ekonomikë, është përcaktuar çmimi 45,000 lekë për një regjistër. Nisur nga ky çmim, u krye verifikim për regjistrat të cilët ishin gjendje në Drejtorinë Spitalore, si dhe çmimin e tyre me regjistra të tjerë të blerë me procedura të tjera prokurimi në FOND, të cilët kishin të njëjtat specifitime, dhe rezultoi se çmimi për regjistër ishte 4,000 lekë, ndërsa nga operatorë të tjerë konstatohet një çmim prej 6150 lekë për copë.

Referuar sa më sipër, blerja e këtyre regjistrave me këto specifitime, nuk e justifikon vlerën e një regjistri prej **45,000 lekë**, pra në këtë rast kemi të bëjmë me një rritje të fondit limit prej **347,150 lekë** (405,000 lekë - 55,350 lekë) trajtuar më hollësisht në faqe 42-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Nga auditimi mbi likuidimet për shërbimet e riparimeve të automjeteve konstatohet se, këto shpenzime për vitin 2014, janë kryer në vlerën e plotë të kontratës së lidhur prej 2,007,000 lekë. Nga verifikimi i tyre konstatohet se, janë kryer shërbime të përsëritura për 4 automjete (nuk ka përsëritje në elementë të veçantë), gjithsej **në shumën 526,560 lekë**, ku për një automjet vlera e riparimit arrin vlerën e plotë të tij, riparime këto të kryera në fund të vitit, mbas një riparimi të mëparshëm pa kaluar afatin e garancisë trajtuar më hollësisht në faqe 49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Nga auditimi për kryerjen e shpenzime për karburantin e automjeteve u konstatua se, për automjetet në dispozicion të institucionit, por dhe të blera rishtas janë aplikuar normativa të larta të harxhimit të karburanti (të cilat variojnë nga 19-21 dhe 10-14 litra/100 km), krahasuar me manualët e tyre, ku si pasojë është konsumuar dhe sasia 6,233 litra, në **vlerën 1,059,610 lekë** trajtuar më hollësisht në faqe 51-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Parregullsitë e konstatuara më sipër kanë sjellë mospërdorimin e fondeve me efikasitet, efikasitet dhe ekonomikitet, me efekte financiare në fondet publike, **gjithsej në shumën 38,597 mijë lekë**.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin nr. 37, të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe Kapitulli XII “Disiplina në Punë”, pika 7 e Rregullores së Brendshme të FSDKSH, miratuar me Urdhrin nr. 541, datë 20.10.2014, të protokolluar me nr. 4145, datë 29.10.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm, **i rekomandoj** Titullarit të Institucionit të marrë masat disiplinore:

a. **“Vërejtje”** deri në **“largim nga puna”**, për:

1. A. Q, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Informacionit dhe Analizës Statistike, e në cilësinë e Kryetarit të KVO-së në 3 tendera, dhe anëtar në tenderin për reklamën;
2. A.V, me detyrë Këshilltar në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO-së në 2 tendera;
3. L.H, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO-së në 1 tender;
4. H.B, me detyrë ish Drejtor Drejtorie dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO-së në 1 tender;
5. J.K, me detyrë Specialiste Informatice në DIAS dhe në cilësinë e anëtares së KVO-së në 4 tendera;
6. R.C, me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë Juridike, e në cilësinë e anëtarit të KVO-së në 3 tendera, dhe kryetar në tenderin për reklamën;
7. I.Ç, me detyrë Juriste në Drejtorinë e Ligjshmërisë së Zhvillimit Fondit, në cilësinë e anëtares së KVO-së në 3 tendera.

b. **“Vërejtje”**, për:

1. F.L, me detyrë Jurist në Drejtorinë Juridike, në cilësinë e anëtares së KVO-së në 2 tendera, si dhe anëtar në tenderin për reklamën;
2. A.N, në cilësinë e anëtares së KVO-së në tenderin për reklamën;
3. E.K, me detyrë Zëdhënëse Shtypi, në cilësinë e anëtares së KVO-së në tenderin për reklamën;
4. M.K, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Trajnimeve, në cilësinë e anëtares së KVO-së në tenderin për reklamën,

me argumentimin sa më poshtë:

-Për sa u konstatuan raste, që Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues pa plotësuar 100% kërkesat kualifikuese, të miratuara nga njësia e prokurimit. Madje të gjithë anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave për rastet e argumentimeve të s’kualifikimeve të operatorëve ekonomikë konkurrues nëpërmjet platformës elektronike, kanë paraqitur të njëjtin tekst pa asnjë ndryshim nga njëri-tjetri, madje edhe me të njëjta shprehje ortografike. Anëtarët e KVO-ve duhet të hyjnë individualisht në platformën elektronike, nëpërmjet llogarisë së tyre të përdoruesit dhe fjalë kalimeve personale. Kjo, në mbështetje të legjislacionit të prokurimit publik si dhe të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik “*Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin publik me mjete elektronike*”, paragrafi i vlerësimit të ofertave bazuar në metodën e paracaktuar të vlerësimit. Sa më sipër çdo anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të japë mendimet më vete.

Po kështu, të gjithë anëtarët e KVO-së kanë të njëjtat argumentime për të tre vlerësimet e dokumenteve, si financiare, teknike dhe faktike, në një kohë, që konkurrenti ka mangësi vetëm për dokumentacionin fjala vjen “*teknik*”. Kur ka mangësi për dokumentacionin “*teknik*”, nuk ka përse të japësh argumente s’kualifikimi për dokumentacion financiar dhe

faktik, ose e kundërta. Pra, mangësia duhet cilësuar vetëm për rubrikën përkatëse të mosplotësimit të kriterëve kualifikuese.

Rastet konkrete cilësohen më të hollësishme dhe me raste konkrete gjatë trajtimit të mangësive të veçanta për tenderat e konstatuara me mangësi e shkelje procedurale;

-Në tenderin me objekt “*Blerje shtypshkrime të Kujdesit Parësor për vitin 2014*”, me fond limit 2,2 milion lekë, me KVO-në me përbërje: A.V-Kryetar (*Drejtoria e Përgjithshme-Këshilltar*); M.K, përgjegjëse Sektori Trajnimeve dhe I.Ç –Jurist (*në Drejtorinë e Legjislacionit të Zhvillimit të Fondit*), pasi në përfundim të auditimit u konstatua mos plotësim të kërkesave kualifikuese nga operatorët ekonomikë konkurrues të shpallur fitues, në një kohë që janë s’kualifikuar operatorë ekonomikë konkurrues të paraqitur me oferta ekonomike me të ulët se fituesi, që duke zbatuar nenin 53 të LPP, pika 4, do ti kishin kursyer buxhetit vlerën prej **130,056 lekë**, çka përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

-Pasi në tenderin me objekt “*Për fushatën e informimit dhe komunikimit për programin e Kontrollit Mjekësor bazë pa pagesë për popullatën 40-65 vjeç*”, të ndarë në dy lote, grupi për ndjekjen e procedurave: R.Ç, me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë Juridike, e në cilësinë e Kryetarit; A.Q, me detyrë Drejtor DIAS; E.K., me detyrë Zëdhënëse Shtypi; F.L, me detyrë Jurist në Drejtorinë Juridike dhe A.N, në cilësinë e anëtarëve, kanë vendosur kërkesa kualifikuese pa paraqitur fiksime përkatëse, çka ka bërë që operatorët ekonomik të mos jenë vlerësuar me bazë të njëjtë krahasimi.

Të tilla kërkesa kualifikuese janë miratuar:

i-Vërtetimi nga administrata tatimore për detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqërore, ku duhej përcaktuar periudha deri në cilën datë duhet, për të bërë vlerësimet e konkurrentëve me të njëjtën bazë krahasimi;

ii-bilancet e 2 viteve të fundit financiar, ku duhej cilësuar të konfirmuara nga administrata tatimore, për të bërë vlerësimet me të njëjtën bazë krahasimi;

iii-kontratat e ngjashme të realizuara gjatë dy viteve të fundit, duke u vlerësuar me sistem pikëzimi, ku duhej të ishte cilësuar edhe vlera përkatëse që, duhet të realizojë çdo konkurrent, brenda 40%, për të bërë vlerësimet e konkurrentëve me bazë të njëjtë krahasimi. Gjithashtu nuk duhej cilësuar dy vitet e fundit, por periudha përkatëse të dy viteve duke marrë si datë të fundit sa më afër kohës së zhvillimit të tenderit *trajtuar më hollësisht në faqe 67-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

E. KALLZIM PENAL

Grupi i auditimit, referuar shkeljeve të dispozitave ligjore me pasojë dëm ekonomik shkaktuar nga rimbursimi i barnave, të konstatuara gjatë auditimit në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, gjykon se ka elementë të veprës penale të “shpërdorimit të detyrës” për:

1. Z. A.B, me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm,
2. Z. S.S, me detyrë ish N/Drejtor i Përgjithshëm,
3. Z. H.B, me detyrë ish Drejtor i Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik,
4. Z. A.Q, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Informacionit dhe Analizës Statistikore.

Pasi, si rrjedhojë e anulimit të kontrollit me inventarizim dhe tematik për barin “*Ketosteril*” në Depon “O”, të pa mbështetura në dispozita ligjore, nuk janë evidentuar problematikat që kjo Depo ka patur lidhur me shitjet fiktive të kryera për barin “*Ketosteril*”, ku si rezultat

subjektet farmaceutike janë rimbursuar padrejtësisht në sasinë **251,093** tableta, me vlerën **30,710,920** lekë e cila përbën dëm ekonomik. Nga institucioni nuk është vepruar për të parandaluar këtë fenomen abuziv, edhe pse në softi-n e tij ka patur të dhëna të mjaftueshme për veprimtarinë e kësaj Depoje.

Sa konstatuar:

-Nga auditimi i dosjes u konstatua se, *nuk ishte realizuar kontrolli sipas programit nr. 1540, datë 25.03.2014, i miratuar nga titullari, për periudhën 25.03.2014 deri në fund të ushtrimit të kontrollit*, me argumentin e moslejimit të ushtrimit të kontrollit nga përfaqësuesit e subjektit, kjo në kundërshtim me nenin 9 të kontratës së lidhur, ku citohet se *“importuesi është i detyruar të pranojë kontrollin me inventarizim dhe tematik të FONDIT, për barnat e listës që rimbursohen”*. Në dokumentacionin e administruar në dosje ishte dhe procesverbali i mbajtur nga grupi i kontrollit në datën 10.04.2014, ku evidentohet fakti se nga pronari i depoz z. Ibrahim Murati nuk ishte lejuar grupi i kontrollit të vazhdonte kontrollin.

-Kontrolli në Depo nuk duhej të anulohet kjo referuar dhe nenit 5 pika 2 e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”*, ku citohet: *“Nëse emri i regjistruar apo shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë vijnë të përdoren, titullari i ri i veprimtarisë trashëgon të gjitha detyrimet tregtare të titullarit të mëparshëm. Marrëveshjet, që përcaktojnë ndryshe nga sa më sipër, nuk mund t'i drejtohen palëve të treta, edhe nëse janë bërë publike, me përjashtim të rastit kur tregtari ose shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për marrëveshjen, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të”,* por dhe detyrimeve kontraktuale, nenit 5 *“Detyrimet e FONDIT”*, ku shprehimisht citohet: *“Fondi dhe Importuesi bien dakord të bëjnë takime të përbashkëta çdo 3 muaj për të ballafaquar të dhënat që kanë të dy palët dhe për sqarimin e problemeve të lindura gjatë zbatimit të kontratës”*.

-Nga auditimi u verifikuan të dhënat e deklaruar nga vetë Depo “O”, me adresë në Kashar, në sistemin e DIAS në FOND për barin *“Calcium-3-menthy-2 oxovalerate...”*, ose ndryshe *“Ketosteril”*, ku u konstatua se nga kjo Depo janë deklaruar në softi-n e FONDI-t, shitje farmaceutike për periudhën janar-Mars 2014, të barit *“Ketosteril”* në sasinë prej 219,625 tableta me çmim rimbursimi 122,3 lekë/tabletë, që arrijnë në vlerën 26,860,137 lekë.

-Po kështu, u kontrolluan dhe deklarimet e bëra për furniturat e kryera nga Depo për barin *“Ketosteril”*, nga ku konstatohet se **nga kjo Depo nuk është deklaruar hyrje asnjë sasi e barit “Ketosteril” nga subjekte farmaceutike.**

-Nga të dhënat e FONDI-t konstatohet se bari *“Ketosteril”* importohet vetëm nga një depo importuese, ku nga verifikimi i mëtejshëm mbi deklarimet në sistemin e DIAS, rezultojnë se kjo depo nuk ka furnizuar asnjëherë me këtë bar depon “O”.

-Nga verifikimi i kryer i listës së 186 subjekteve farmaceutike, të cilat janë furnizuar nëpërmjet Depos “O” del se, ato janë gjithsej 186 farmaci, ku ndër to evidentohet disa farmaci të furnizuara me sasi dhe numër faturash të larta, si farmaceutikët: “BP”, “B L”, “K-A”, “L”, “V VI”, “Xh”, “Bt”, “K-f”, “S”, etj. (lista bashkangjitur), ku konstatohet se në këtë listë ka dhe subjekte të cilat nuk janë subjekte farmaceutike, por thjesht “Klient Kesh”, pra të pa identifikuar si subjekt farmaceutik, nga të cilët janë kryer kthime me (-) të barit në sasinë prej 126,853 tableta, gjë e cila verifikon se veprimet janë abuzive dhe jo korrekte.

-Për periudhën 01.04.2014 deri në 30.03.2015, ky bar ka kaluar për rimbursim në farmaceutikët e QSUT dhe ato të Spitaleve dhe nga verifikimi i deklarimit të Depos “O” për këtë periudhë, (ndërkohë që bari *“Ketosteril”* nuk ka qenë për treg të hapur farmaceutik, por vetëm në QSUT), rezultojnë se janë bërë shitje gjithsej në 10 farmaci, në sasinë prej 12.5 tableta x 97.2 lekë/tabletë =1,215 lekë (referuar LBR 2014).

-Për periudhën Prill – Maj 2015 përsëri bari del në tregun e hapur farmaceutik dhe nga verifikimi i deklarimeve të Depos “O” për këtë periudhë janë kryer shitje për 453 tableta x 90.8 lekë/tabletë dhe vlera e rimbursu është 41,132 lekë.

Për këto periudha kohore, sipas informacioneve të marra nga DIAS, Depo “O”, Kashar, nuk ka deklaruar asnjë furniturë në sistem.

Si rezultat i shitjeve fiktive, të kryera nga Depo “O”, me seli në Kashar, për barin “Ketosteril”, janë rimbursuar subjekteve farmaceutike në sasinë prej **220,090** tableta, me vlerën e rimbursuar **26.902,485** lekë.

-Nisur nga shkeljet e konstatuara u kryen verifikime në sistemin e DIAS në FOND ku rezultoi se Depo “O” me adresë në Tiranë me të njëjtin pronar, për periudhën Janar –Mars 2014, (nga kjo Depo, Tiranë) janë deklaruar në fond shitje sipas farmacive (lista bashkangjitur) një sasi bari “Ketosteril” prej 30,900 tableta, me çmim rimbursimi prej 122,3 lekë, në vlerë gjithsej prej 3,799,070 lekë, ndërkohë që në deklaratimet e bëra për furniturat e kryera nga Depo për “Ketosteril” konstatohet se, nga Depo nuk është deklaruar hyrje asnjë sasi e barit “Ketosteril”.

-Gjithashtu, nga verifikimi i listës së subjekteve farmaceutikë të furnizuara nga kjo depo rezultoi se janë 96 farmaci, të furnizuara me fatura me sasi dhe vlera të larta, ndër ta ka subjekte të cilët nuk janë subjekte farmaceutike, por thjesht “Klient Kesh”, pra të pa identifikuar si subjekte farmaceutike, nga të cilët janë kryer kthime me (-) të barit në sasi prej 4,727 tableta, gjë e cila verifikon se veprimet janë abuzive dhe jo korrekte.

-Nga Depo “O” (Tiranë) edhe për periudhën (janar – mars 2015) kur bari “Ketosterili” nuk ka qenë për treg të hapur farmaceutik, por vetëm në QSUT, janë bërë shitje në subjekte farmaceutike sasia prej 2 tabletash x 97.2=194 lekë/tabletë (LBR 2014).

-Për periudhën (Prill – Maj 2015) bari “Ketosterili” përsëri ka dalë në tregun e hapur farmaceutik, u verifikuan deklaratimet për këtë periudhë dhe rezultoi se nga Depo “O” (Tiranë) janë kryer shitje për 101 tableta me çmim 90.8 lekë/tabletë dhe vlera e rimbursuar është 9,170 lekë.

Pra, nga Depo “O”, me adresë në Tiranë u është shitur fiktivisht bari “Ketosterili” subjekteve farmaceutike, gjithsej **31,003** tableta, të cilët nëpërmjet recetave fiktive kanë përfituar një vlerë rimbursimi **3,808,435** lekë.

-Për sa më lart, konkludojmë se, Depo farmaceutike “O”, Kashar dhe Tiranë, referuar dhe deklaratimeve të bëra nga vetë depo në sistemin e DIAS në FOND mbi barin “Ketosteril”, ka deklaruar shitje fiktive nga (Depo Kashar) në sasinë prej 220,090 tableta në vlerë të rimbursuar prej 26,902,485 lekë dhe nga (Depo Tiranë) në sasinë prej 31,003 tableta në vlerë rimbursimi 3,808,435 lekë.

Në total nga Depo farmaceutike “O”, janë shitur fiktivisht **251,093** tableta bari “Ketosteril”, me vlerë rimbursimi prej **30,710,920** lekë, të përfituara padrejtësisht dhe në mënyrë fiktive nga subjektet farmaceutike.

Sa më lart:

Anullimi i kontrollit, interpretimi i kryer nga Drejtoria Juridike, mungesat dhe vonesat në informacione, mos kryerja e monitorimit, mos raportimi dhe mosevidentimi i mospërputhjeve në deklaratime ngarkojnë me përgjegjësi z. A.B, z. H.B, z. S.S dhe z. A.Q, të cilët duke mos ndaluar furnizimin dhe rimbursimin kanë vepruar në kundërshtim edhe me Rregulloren “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës” për Drejtorinë e Përgjithshme të FONDIT, e cila ka dalë në mbështetje dhe për zbatim të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: ...Drejtorja e Informacionit dhe Analizës Statistikore, e

cila ka si objekt pune realizimin e informatizimit të skemës së sigurimeve shëndetësore, si dhe përpunimin dhe analizën në rang kombëtar të të gjithë treguesve statistikore ... ka për detyrë të ndjekë aktivitetin e Depove Grosiste, farmacive dhe Qendrave Shëndetësore që kanë kontratë me FONDI-n. Kjo Drejtori analizon treguesit dhe i vë në dispozicion të Drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm ...Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik, e cila ka si objekt pune kontrollin e zbatimit të detyrimeve të subjekteve të kontraktuara me FONDI-n duke përfshirë Qendrat Shëndetësore, Farmacitë dhe Depot Farmaceutike, me qëllim që të parandalojë dhe identifikojë veprimtarinë e kundërligjshme dhe abuzive, në zbatim të skemës së kujdesit shëndetësor.

F. TË TJERA

1. Është rekomanduar që nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë të vlerësohet situata financiare e subjektit “O”, me adresa në Kashar dhe Tiranë, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.05.2015, pasi nga auditimi i kryer në sistemin informatik të Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, rezulton se ky subjekt farmaceutik, për këtë periudhë, ka realizuar shitje vetëm për barin “Ketosteril” ***në sasinë 251,093 tableta, në vlerën e rimbursimit për 30,710,920 lekë, ndërkohë që nuk ka raportuar hyrje nga subjekte të tjera farmaceutike, por vetëm nga klientë të paidentifikuar “Kesh”, konfirmuar kjo dhe nga korrespondenca me këtë institucion.***

2. Ky auditim është vlerësuar shumë i dobët nga Kryetarit i KLSH-së. Nisur nga sa më sipër për të vlerësuar punën e audituesve dhe në mënyrë që të plotësohen gjetjet dhe të mbulohen të gjitha zonat me risk, kjo periudhë do të riauditohet nga KLSH-ja, në auditimin në vijim që do të ushtrohet në këtë subjekt, me objekt funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të skemës së sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, në përputhje me politikat kombëtare të kujdesit shëndetësor. Materialet e auditimit do të evadohen mbas datës 15.10.2015.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Selime Bregu përgjegjës grupi, Ymer Stafa, Valentina Sulo dhe Benard Haka, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe nga Drejtori i Departamentit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT